



7/3  
02.09.2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

Nr. 153/ Prot.  
3.

Tiranë, më 31.08.2016

DREJTUAR : UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI"

KORÇË

LËNDA : PËR PËRFUNDIMET E MISIONIT TË AUDITIMIT

Nga data 20.06.2016 deri në datën 01.07.2016, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ka zhvilluar një mision auditimi, në Universitetin "Fan S. Noli", me objekt "Auditim i plotë, duke bërë vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, vlerësimin e riskut, dhënien e rekomandimeve dhe këshillave për përmirësimin e sistemeve në arritjen e objektivave", për periudhën 01.06.2014 deri më 31.05.2016.

Bashkëngjitur ju dërgojmë:

- Raportin final të auditimit
- Formatin standard "Anketa për reagimet nga auditimi"

Gjatë realizimit të këtij misioni, auditimi ka konstatuar:

- Pronat e Universitetit nuk janë të hipotekuara.
- Detyrat e lëna nga auditimi i mëparshëm, sipas Shkresës nr. 1725/3 prot, datë 03.07.2014, të Ministres së Arsimit dhe Sportit, janë realizuar.
- Lidhur me kontrollin e realizuar në Universitetin e Korçës, "Për zbatimin e ligjshmërisë", në zbatim të Urdhrit nr.242, datë 06.06.2014 "Për ngritjen e nëngrupit të punës në zbatim të Urdhrit nr.106, datë 28.03.2014, në "Draft Raportin" e dërguar me shkresën nr.4537/8, datë 02.07.2014, nuk janë lënë rekomandime, por auditimi, ka analizuar të gjitha gjetjet e konstatuara nga grupi i punës dhe ka pasqyruar masat e marra nga Universiteti për përmirësimin e gjendjes si dhe gjendjen aktuale.
- Dosja e tenderit me objekt "Shërbimi i sigurisë dhe ruajtjes fizike", nuk është audituar nga Njësia e Auditimit të MAS-it, sepse, me urdhrin e Kryeministrit nr.2470, datë 13.04.2016, Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Anti Korrupsion pranë

Kryeministrit, ka ushtruar kontroll administrative dhe ligjor lidhur me zbatimin e procedurave ligjore dhe administrative të ndjekura në prokurimin e tenderit të këtij objekti. Në përfundim të kontrollit me shkresën nr.2470/1, datë 27.06.2016, është dërguar raporti i kontrollit dhe për shkeljet e konstatuara janë dhënë masat përkatëse.

Mbështetur në kërkesat e Ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe aktet e tjera nënligjore që lidhen me auditimin e brendshëm,

### URDHËROJ:

#### Të realizohet detyra:

- 1- Universiteti "Fan S. Noli" Korçë. në bashkëpunim me Drejtoria e Financës pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të ndjekë procedurat për regjistrimin e pronave të Universitetit, në Zyrat e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme:

Në zbatim të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, në bashkëpunim me Drejtoria e Financës pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të marrë masa të plota për zbatimin e kësaj detyre, si dhe të njoftojë me shkrim Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, mbi realizimin e saj.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

